

VENDIM
Nr.246, datë 14.6.1997

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DISA NDRYSHIMEVE TË MARRËVESHJES PËR
PROJEKTIN “MBËSHTETJA PËR HEDHJEN E BAZAVE TË VEPRIMTARISË
SIPËRMARRËSE”**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Departamentit të Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të disa ndryshimeve të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për projektin “Mbështetja për hedhjen e bazave të veprimtarisë sipërmarrëse” të datës 5 korrik 1994.

2. Për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes të këtij projekti ngarkohet Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

3. Për zbatimin e procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje autorizohet Ministria e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino